



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, më 4 shtator 2012, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi- zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë z. Ferid Agani;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Ferid Agani

Fikrim Damka- Tha se ministri ka kërkuar takim me ne, lidhur me disa propozime të reja në Ligjin për shëndetësinë. Fjalën ia dha ministrit, z. Ferid Agani.

Ferid Agani- Deklaroi se i kam përcjellë debatet lidhur me këtë projektligj. Në funksion të një pune sa më të mirë, Ministria ka vendosur të bëjë disa propozime të reja në këtë projektligj. Unë e kam përgatitur një letër për kryesuesin e Komisionit. Jam konsultuar me një grup ekspertësh juridikë, lidhur me modalitetet e qartësimit të këtij teksti ligjor. Ne duhet të kemi konsensus, sepse këtë e kërkon reforma e filluar. Ne i kemi hartuar 7 amendamente, të cilat do të mund t'i shërbejnë Komisionit në funksion të bërjes së një ligji sa më të mirë. Në tërë tekstin e projektligjit, duhet të ndryshohet fjala “qytetar” dhe të zëvendësohet me fjalën “shtetas”. Po ashtu, amendamentet tjera janë lidhur me përkufizimin e institucioneve shëndetësore, Shërbimin spitalor dhe klinik të Kosovës, veprimtarinë shëndetësore si veprimtari me interes të veçantë publik etj. Me këtë ligj, po krijohet një institucion i ri shëndetësor në nivelin sekondar dhe terciar. Ky shërbim do të mundësojë një shfrytëzim sa më racional të çdo lloj resursi.

Liburn Aliu- Tha se nuk ka qenë e nevojshme të mbahet ky lloj takimi. Unë nuk jam i përgatitur të diskutoj për këtë tekst që posa na u dha, sepse nuk kemi kohë ta analizojmë. Unë mund të diskutoj herëve të tjera, lidhur me këtë çështje.

Time Kadriaj- Ne jemi të hapur për të pranuar propozime për ndryshime në pjesë të caktuara të ligjit, të cilat propozime do t'i kemi parasysh gjatë procesit të amendamentimit.

Flora Brovina- Tha se shëndetësia ka nevojë për reforma të mëdha. Propozimit që Shërbimi spitalor klinik të jetë joprofitabil, mendon se duhet t'i shtohet edhe pjesa se ky shërbim është me interes të veçantë publik.

Salihe Mustafa- Deklaroi se nga këto propozime shihet përkushtimi i ministrit lidhur me këtë ligj. Ne do t'i kemi parasysh këto propozime. Në bordin e Shërbimit spitalor dhe klinik, do të ishte mirë që të caktohet më saktë se si zgjidhen përfaqësuesit e spitaleve rajonale në këtë bord.

Nazane Breca- Tha se po e vërej se në këtë ligj po bëhet një ndarje e sistemit primar shëndetësor dhe shihet se ky nivel nuk është i përfshirë në Shërbimin shëndetësor të përcaktuar me këtë ligj.

Ferid Agani- Duke u përgjigjur në çështjet e ngritura, tha se niveli primar është shtyllë e sistemit shëndetësor në vend. Me këtë ligj, ne do të merremi me nivelin sekondar dhe terciar, ndërkaq riorganizimin e nivelit primar nuk do ta bëjmë tash për tash, për shkak se kemi disa kufizime me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Ne po i bashkojmë spitalet rajonale dhe QKUK-në, në një tërësi. Niveli primar është i mbështetur në çdo aspekt dhe ky nivel do të ketë raporte të qarta me nivelet e tjera të kujdesit shëndetësor. Problemet më të mëdha i kemi në nivelin sekondar dhe terciar.

Sipas vlerësimeve të ekspertëve, me këtë ligj ne jemi një hap përpara, krahasuar me gjithë segmentet tjerë.

Nazane Breca- Tha se mosprezenca e një anëtari në bordin e kësaj ndërmarrjeje nga kujdesi parësor, do ta vështirësojë ndërlidhjen e këtij niveli me nivelet tjera.

Time Kadriaj- Tha se nuk ka kurrfarë kuptimi që në këtë bord të jetë përfaqësuesi nga kujdesi primar.

3. Të ndryshme

Fikrim Damka- E njoftoi Komisionin se do të organizohet një punëtori për shqyrtimin e këtij Projektligji, e cila do të mbahet në Prevallë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka